

SNK 32 Instrumentat Financiarë: Paraqitja dhe SNK 1 Paraqitja e
Pasqyrave Financiare

**Instrumentat Financiarë të kthyeshëm dhe Detyrimet që
Lindin nga Likuidimi**

Ndryshime ndaj SNRF-ve

Ky dokument paraqet ndryshimet në SNK 32 Instrumentat Financiarë: Paraqitja dhe SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare (rishikuar në 2007) dhe ndryshimet rezultuese në SNRF 7 Instrumentat Financiarë: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese, në SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja dhe KIRFN 2 *Aksionet e Anëtarëve në Njësitë ekonomike kooperative dhe Instrumentat e Ngjashëm*. Ky dokument përmban edhe ndryshimet në Bazën për Konkluzione të SNK 32 dhe SNK 1 dhe shembujt ilustrues që shoqërojnë SNK 32. Ndryshimet rezultojnë nga propozimet që ishin përfshirë në projekt paraqitjen e ndryshimeve të propozuara për SNK 32 dhe SNK 1 – Instrumentat Financiarë të kthyeshme me Vlerën e Drejtë dhe Detyrimet që lindin nga Likuidimi, të publikuara në Qershor të vitit 2006.

Njësitë ekonomike duhet të zbatojnë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2009 ose më pas. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse njësitë ekonomike i zbatojnë këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ato duhet të japin informacione për këtë fakt në shënimet shpjeguese.

Ndryshimet në SNK 32 Instrumentat Financiarë: Paraqitja

Në paragrafin 11 të Standardit, ndryshohen përkufizimet për një aktiv financiar dhe një pasiv financiar dhe pas përkufizimit të vlerës së drejtë shtohet përkufizimi i një instrumenti me opsinin i shitshëm .

Përkufizimet (shih edhe paragrafët AG3-AG23)

11 Termat në vijim përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuara:

...

Një aktiv financiar është çdo aktiv, i cili është:

- (a) ...
- (d) një kontratë që do të shlyhet ose mund të shlyhet me instrumentat e kapitalit të vet të njësisë ekonomike dhe është:
 - (i) ...
 - (ii) një derivativ që do të shlyhet ose mund të shlyhet ndryshe nga këmbimi i një shumë fikse të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar për një numër të caktuar të instrumentave të kapitalit të vet të njësisë ekonomike. Për këtë qëllim instrumentat e kapitalit të vet të njësisë ekonomike nuk përfshijnë instrumentat financiarë të kthyeshme të klasifikuara si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B, instrumenta të cilët krijojnë për njësinë ekonomike një detyrim për të lëvruar tek pala tjetër një pjesë prporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim dhe që janë klasifikuar si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16C dhe 16D, ose instrumenta që janë kontrata për marrjen ose lëvrimin e ardhshëm të instrumentave të kapitalit të vet të njësisë ekonomike.

Një pasiv financiar është një pasiv, i cili është:

- (a) një detyrim kontraktual :
 - (i) për të lëvruar mjetet monetare ose një aktiv tjetër financiar tek një njësi tjetër ekonomike; ose
 - (ii) për të shkëmbyer aktive financiare ose pasive financiare me një njësi ekonomike tjetër sipas kushteve që janë potencialisht të pafavorshme për njësinë ekonomike; ose
- (b) një kontratë që do të shlyhet ose mund të shlyhet në instrumenta të kapitalit të vet të njësisë ekonomike dhe është:
 - (i) një jo-derivativ për të cilin njësia ekonomike është ose mund të jetë e detyruar të lëvrojë një numër të ndryshueshëm të instrumentave të kapitalit të vet të njësisë ekonomike; ose
 - (ii) një derivativ që do të shlyhet ose mund të shlyhet ndryshe nga këmbimi i një shume të caktuar mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar për një numër të caktuar të instrumentave të kapitalit të vet të njësisë ekonomike. Për këtë qëllim instrumentat e kapitalit të vet të njësisë ekonomike nuk përfshijnë instrumentat financiarë të kthyeshme, që janë klasifikuar si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B, instrumenta që i krijojnë njësisë ekonomike një detyrim për të lëvruar tek një palë tjetër një pjesë prporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim dhe janë klasifikuar si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16C dhe 16D ose instrumenta që janë kontrata për marrje ose lëvrime të ardhshme të instrumentave të kapitalit të vet të njësisë ekonomike

Përfundimisht, një instrument që plotëson përkufizimin e një pasivi financiar, klasifikohet si një instrument i kapitalit të vet nëse ai ka të gjitha tiparet dhe plotëson kushtet që jepen në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D.

...

Një instrument financiar i kthyeshëm është një instrument financiar që i jep mbajtësit të drejtën të kthejë instrumentin tek emetuesi kundrejt mjeteve monetare ose një aktivi financiar tjetër ose që është automatikisht i kthyeshëm tek emetuesi me ndodhjen e një ngjarjeje të ardhshme të pasigurt ose me vdekjen apo daljen në pension të mbajtësit të instrumentit.

Titujt para paragrafit 15 dhe paragrafit 16 janë ndryshuar. Pas paragrafit 16, një titull, paragrafët 16A dhe 16B, një tjetër titull, paragrafët 16C dhe 16D, një tjetër titull dhe janë shtuar paragrafët 16E dhe 16F.

Paraqitja

Pasivet dhe kapitali I vet (shih edhe paragrafët AG13-AG14J dhe AG25-AG29A)

...

16 Nëse një emetues, për të përcaktuar nëse një instrument financiar është një instrument i kapitalit të vet apo një pasiv financiar, zbaton përkufizimet e dhëna në paragrafin 11, instrumenti është një instrument i kapitalit të vet në qoftë se dhe dhe vetëm në qoftë se plotësohen njëkohësisht kushtet (a) dhe (b) të mëposhtëme.

(a) ...

(b) Nëse instrumenti do të shlyhet ose mund të shlyhet në instrumenta të kapitalit të vet të emetuesit, ai është:

(i) ...

(ii) një derivativ që do të shlyhet vetëm nga emetuesi në këmbim të një shume të caktuar të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar për një numër të caktuar të instrumentave të kapitalit të vet. Për këtë qëllim, instrumentat e kapitalit të vet të emetuesit nuk përfshijnë instrumentat që kanë të gjitha tiparet dhe plotësojnë kushtet e përshkruara në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D, ose instrumentat që janë kontrata për marrje ose për lëvrime të ardhshme të instrumentave të kapitalit të vet të emetuesit.

Një detyrim kontraktual, përfshirë atë që vjen nga një instrument derivative financiar, që do të sjellë ose mund të sjellë marrje ose lëvrime të ardhshme të instrumentave të kapitalit të vet të emetuesit, por që nuk plotëson kushtet (a) dhe (b) më sipër, nuk është instrument i kapitalit të vet. Përfshirë, një instrument që plotëson përkufizimin e një pasivi financiar do të klasifikohet si një instrument i kapitalit të vet nëse ai ka të gjitha tiparet dhe plotëson kushtet e dhëna në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D.

Instrumentat financiarë të kthyeshëm

16A Një instrument financiar i kthyeshëm përfshin një detyrim kontraktual për emetuesin që të riblejë ose të shlyejë atë instrument në mjete monetare ose me aktiv financiar tjetër kur ushtrohet e drejta e kthimit. Një instrument që përfshin një detyrim të tillë bën përjashtim nga përkufizimi i pasivit financiar e klasifikohet si një instrument kapitali nëse ka të gjitha tiparet në vijim:

(a) I jep të drejtën mbajtësit për një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike në rast të likuidimit të njësisë ekonomike. Aktivet neto të njësisë ekonomike janë ato aktive që mbeten pasi zbriten të gjitha kërkesat e tjera mbi aktivet e saj. Pjesa proporcionale përcaktohet si vijon:

(i) ndahen aktivet neto të njësisë ekonomike në likuidim në njësi me vlera të barabarta; dhe

(ii) shumëzohet kjo vlerë me numrin e njësive që mbahen nga mbajtësi i instrumentit financiar.

(b) Instrumenti është në klasën e instrumentave që janë në varësi të gjithë klasave të tjera të instrumentave. Për të qenë në një klasë të tillë instrumenti:

(i) nuk duhet të ketë përparësi kundrejt kërkesave të tjera të aktiveve të njësisë ekonomike në likuidim, dhe

(ii) nuk ka nevojë të konvertohet në një instrument tjetër para se të jetë në klasën e instrumentave që është në varësi të të gjitha klasave të tjera të instrumentave.

(c) Të gjithë instrumentat financiarë në klasën e instrumentave që është në varësi të të gjitha klasave të tjera të instrumentave kanë tipare identike. Për shembull, të gjithë ata duhet të jenë të kthyeshëm dhe formula apo metoda që përdoret për të llogaritur çmimin e riblerjes ose të rishlyerjes është e njëjtë për të gjithë instrumentat e asaj klase.

- (d) Përveç detyrimit kontraktual të emetuesit për të riblerë ose shlyer instrumentin në mjete monetare ose aktiv financiar tjetër, instrumenti nuk përfshin ndonjë detyrim tjetër kontraktual për të lëvruar mjete monetare ose aktiv financiar tjetër tek një njësi tjetër ekonomike ose për të këmbyer aktive financiare ose pasive financiare me një njësi tjetër ekonomike sipas kushteve që janë potencialisht të pafavorshme për njësinë ekonomike dhe nuk është një kontratë e cila do të shlyhet ose mund të shlyhet në instrumenta të kapitalit të vet të njësisë ekonomike siç paraqitet në nënparagrafin (b) të përkufizimit të një pasivi financiar.
- (e) Flukset totale të pritëshme të mjeteve monetare që i ngarkohen instrumentit përgjatë jetës së tij bazohen kryesisht në fitimin ose humbjen, ndryshimin në aktivet neto të njohura ose në ndryshimin në vlerën e drejtë të aktiveve neto të njohura dhe të panjohura të njësisë ekonomike përgjatë jetës së instrumentit (përfashtuar çdo efekt të instrumentit).

16B Që një instrument të klasifikohet si një instrument i kapitalit të vet përveçse instrumenti duhet të ketë të gjithë tiparet e mësipërme, emetuesi duhet të mos ketë asnjë instrument tjetër ose kontratë financiare që ka:

- (a) flukse totale të mjeteve monetare të bazuara kryesisht në fitimin ose humbjen, në ndryshimin në aktivet neto të njohura ose në ndryshimin në vlerën e drejtë të aktiveve neto të njohura dhe të panjohura të njësisë ekonomike (duke përfashtuar çdo efekt të instrumentave ose kontratave të tilla) dhe
- (b) efekt kufizues të rëndësishëm ose fiksues të kthimit të mbetur tek mbajtësi i instrumentit të kthyeshëm.

Që të mund të zbatohet këtë kusht njësi ekonomike nuk duhet të marrë në konsideratë kontratat jo-financiare me një mbajtës të një instrumenti të përshkruara në paragrafin 16A, të cilat kanë kushte kontratale që janë të ngjashme me kushtet kontratale të një kontrate të barasvlefshme që mund të lindë mes një jo-mbajtësi instrumenti dhe njësisë ekonomike emetuese. Nëse njësi ekonomike nuk mund të përcaktojë që ky kusht është plotësuar, ajo nuk duhet të klasifikojë instrumentin e kthyeshëm si një instrument të kapitalit të vet.

Instrumentat ose përbërësit e instrumentave, që i krijojnë njësisë ekonomike një detyrim për të lëvruar tek një palë tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim

16C Disa instrumenta financiarë përfshijë një detyrim kontraktual për njësinë emetuese për të lëvruar tek një njësi tjetër ekonomike një pjesë proporcionale të aktiveve neto të saj vetëm në likuidim. Detyrimi krijohet ose sepse likuidimi është i sigurt që do të ndodhë dhe jashtë kontrollit të njësisë ekonomike (për shembull, një njësi ekonomike me jetë të kufizuar) ose sepse është i pasigurt për të ndodhur por është në psonin e mbajtësit të instrumentit. Përfashtimisht nga përkufizimi i një pasivi financiar, një instrument që përfshin një detyrim të tillë klasifikohet si një instrument i kapitalit të vet nëse ai ka të gjitha tiparet në vijim:

- (a) I jep të drejtën mbajtësit për një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike në rast të likuidimit të njësisë ekonomike. Aktivet neto të njësisë ekonomike janë ato aktive që mbeten pasi zbriten të gjithë kërkesat e tjera mbi aktivet e saj. Një pjesë proporcionale përcaktohet duke:
 - (i) pjesëtuar aktivet neto të njësisë ekonomike në likuidim në njësi me vlera të barabartë; dhe
 - (ii) duke shumëzuar këtë vlerë me numrin e njësive që mbahen nga mbajtësi i instrumentit financiar.
- (b) Instrumenti është në një klasë instrumentash që është në varësi të të gjithë klasave të tjera të instrumentave. Që të jetë në një klasë të tillë, instrumenti:
 - (i) nuk ka përparësi ndaj kërkesave të tjera mbi aktivet e njësive ekonomike në likuidim, dhe
 - (ii) nuk ka nevojë të konvertohet në një instrument tjetër financiar para se të jetë në klasën e instrumentave që është në varësi të të gjithë klasave të tjera të instrumentave.
- (c) Të gjithë instrumentat financiarë në klasën e instrumentave që është në varësi të të gjithë klasave të tjera të instrumentave duhet të kenë një detyrim kontraktual identik për njësinë ekonomike emetuese, për të lëvruar një pjesë proporcionale të aktiveve neto të saj në likuidim.

16D Që një instrument të klasifikohet si një instrument i kapitalit të vet, përveç faktit që instrumenti duhet të ketë të gjitha tiparet e mësipërme, emetuesi duhet të mos ketë asnjë instrument tjetër ose kontratë financiare që ka:

- (a) flukse totale të mjeteve monetare të bazuara kryesisht në fitimin ose humbjen, ndryshimin në aktivet neto të njohura ose ndryshimin në vlerën e drejtë të aktiveve neto të njohura dhe të panjohura të njësisë ekonomike (duke përfashtuar çdo efekt të instrumentave ose kontratave të tilla) dhe
- (b) efekt kufizues të rëndësishëm ose fiksues të kthimit të mbetur tek mbajtësi i instrumentit të kthyeshëm.

Për qëllime të zbatimit të këtij kushti njësia ekonomike nuk duhet të marrë në konsideratë kontratat jo-financiare me një mbajtës të një instrumenti të përshkruar në paragrafin 16C që ka kushte kontraktuale të cilat janë të ngjashme me kushtet kontraktuale të një kontrate të barasvlefshme që mund të lindë mes një jo-mbajtësi instrumenti dhe njësisë ekonomike emetuese. Nëse njësia ekonomike nuk mund të përcaktojë që ky kusht është plotësuar, ajo nuk duhet të klasifikojë instrumentin e kthyeshëm si një instrument të kapitalit të vet.

Riklasifikimi i instrumentave të kthyeshëm dhe instrumentave që i krijojnë njësisë ekonomike një detyrim për të lëvruar tek një palë tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim

- 16E Një njësi eomie do të klasifikojë një instrument financiar si një instrument të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D, që prej datës që instrumenti gëzon të gjitha tiparet dhe plotëson kushtet e paraqitura në këto paragrafë. Një njësi ekonomike do të riklasifikojë një instrument financiar që prej datës kur instrumenti pushon së pasuri të gjitha tiparet ose nuk plotëson kushtet e paraqitura në këto paragrafë. Për shembull, nëse një njësi ekonomike shlyen të gjithë instrumentat e saj jo-të kthyeshëm të emtuar dhe çdo instrument i kthyeshëm që mbetet për t'u shlyer gëzon të gjitha tiparet dhe plotëson kushtet e dhëna në paragrafët 16A dhe 16B, njësia ekonomike do të riklasifikojë instrumentat e kthyeshëm si instrumenta të kapitalit të vet që prej datës kur ajo shlyen instrumentat jo-të kthyeshëm.
- 16F Një njësi ekonomike duhet të marrë parasysh sa vijon për të rilasifikuar një instrument në përputhje me paragrafin 16E:
- (a) Duhet të riklasifikojë një instrument të kapitalit të vet si një pasiv financiar që prej datës kur instrumenti nuk gëzon më tiparet ose nuk plotëson kushtet e paragrafëve 16A dhe 16B ose paragrafëve 16C dhe 16D. Pasivi financiar do të matet me vlerën e drejtë të instrumentit në datën e riklasifikimit. Njësia ekonomike do të njohë në kapitalin e vet çdo diferencë mes vlerës kontabël që mbart instrumenti i kapitalit të vet dhe vlerës së drejtë të pasivit financiar në datën e riklasifikimit.
 - (b) Duhet të riklasifikojë një pasiv financiar si kapital i vet që prej datës kur instrumenti gëzon të gjitha tiparet dhe plotëson kushtet e paraqitura në paragrafët 16A dhe 16B ose në paragrafët 16C dhe 16D. Një instrument i kapitalit të vet do të matet me vlerën kontabël të pasivit financiar në datën e riklasifikimit.

Paragrafët 17–19 janë ndryshuar.

Jo detyrim kontraktual për të lëvruar mjete monetare ose aktive të tjera fiannciare (paragrafi 16(a))

- 17 Me përjashtim të situatave të përshkruara në paragrafët 16A dhe 16B ose në paragrafët 16C dhe 16D, një tipar kyç në dallimin e një pasivi financiar nga një instrument i kapitalit të vet, është ekzistenca e një detyrimi kontraktual e një pale për instrumentin financiar (emetuesi) ose për të lëvruar mjete monetare apo aktive të tjera financiare tek pala tjetër (mbajtësi) ose për të këmbyer aktive financiare apo pasive financiare me mbajtësin sipas kushteve që janë potencialisht të pafavorshme për emetuesin. ...
- 18 Klasifikimi i një instrumenti financiar në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike bazohet jo aq në formën ligjore, sa ai bazohet në thelbin e instrumentit financiar. Zakonisht thelbi dhe forma ligjore përputhen, por jo gjithmonë. Disa instrumenta financiarë marrin formën ligjore të kapitalit të vet por në thelb janë pasive dhe të tjerë mund të kombinojnë tipare që lidhen me instrumentat e kapitalit të vet dhe tipare që lidhen me pasivet financiare. Për shembull:
- (a) ...
 - (b) një instrument financiar që i jep mbajtësit të drejtën ta kthejë tek emetuesi kundrejt mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare (një 'instrument i kthyeshëm') është një pasiv financiar, përveç rastit kur keto instrumenta klasifikohen si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D. Instrumenti financiar është një pasiv financiar edhe nëse shuma e mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare përcaktohet në bazë të një indeksi ose zëri tjetër që ka mundësi të rritet ose zvogëlohet. Ekzistenca e një opsioni për mbajtësin që të kthejë instrumentin te emetuesi kundrejt mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare, nënkupton që instrumenti i kthyeshëm plotëson përkufizimin e një pasivi financiar përveç instrumentave të klasifikuar si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16b ose paragraftë 16C dhe 16D. Për shembull, fondet e përbashkëta të hapura, njësitë truste, bashkëpronësitë dhe disa njësi ekonomike të përbashkëta mund t'u sigurojnë mbajtësve ose anëtarëve të tyre të drejtën për të shlyer interesat e tyre nga emetuesi në çdo kohë kundrejt mjeteve monetare, cka bën që që interesat e njësisë mbajtëse ose të anëtarëve të klasifikohen si pasive fiannciare, përveç atyre instrumentave të klasifikuara si

instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D. Megjithatë, klasifikimi si një pasiv financiar nuk pengon përdorimin e përcaktimeve si 'vlera e aktiveve neto që u takon njësi mbajtësve' dhe 'ndryshimi në vlerën e aktiveve neto që u takon njësi mbajtësve' në pasqyrat financiare të një njësie ekonomike që nuk ka kapital të vet të kontribuar (si p.sh. disa fonde të përbashkëta dhe njësitë truste, shih Shembullin Ilustrues 7) ose përdorimin e dhënies së shpjegimeve shtesë për të treguar se interesi total i anëtarëve përfshin zëra të tillë si rezervat që plotësojnë përkufizimin e kapitalit të vet dhe të instrumentave të kthyesëm që nuk e plotësojnë këtë përkufizim (shih Shembullin Ilustrues 8).

- 19 Nëse një njësi ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shmangur lëvrimin e mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare për të shyer një detyrim kontraktual, detyrimi plotëson përkufizimin e një pasivi financiar përveç instrumentave të klasifikuar si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D. Për shembull:

...

Paragrafët 22, 23 dhe 25 janë ndryshuar. Pas paragrafit 22, shtohet paragrafi 22A.

Shlyerja me instrumenta të kapitalit të vet të njësisë ekonomike (paragrafi 16(b))

- 22 Me përjashtim të përcaktimit në paragrafin 22A, një kontratë që do të shlyhet nga njësi ekonomike duke (marrë ose) lëvruar një numër të caktuar të instrumentave të kapitalit të vet në këmbim të një shume të caktuar të mjeteve monetare ose të aktivi financiar tjetër është një instrument i kapitalit të vet. Për shembull, ...
- 22A Nëse instrumentat e kapitalit të vet të njësisë ekonomike që do të merren, ose lëvrohen, nga njësi ekonomike për të shlyer një kontratë, janë instrumenta financiarë të kthyesëm me të gjitha tiparet dhe plotësojnë kushtet e përshkruara në paragrafët 16A dhe 16B ose instrumenta që i krijojnë njësisë ekonomike një detyrim për të lëvruar tek pala tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim me të gjitha tiparet dhe plotësojnë kushtet e përshkruara në paragrafët 16C dhe 16D, kontrata është një aktiv financiar ose një pasiv financiar. Kjo përfshin një kontratë që do të shlyhet nga njësi ekonomike duke marrë ose lëvruar një numër të caktuar të instrumentave të tillë në këmbim të një shume të caktuar të mjeteve monetare ose të aktiveve financiare të tjera.
- 23 Me përjashtim të situatave të përshkruara në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D, një kontratë që përmban një detyrim për një njësi ekonomike për të blerë instrumentat e vet të kapitalit të vet kundrejt mjeteve monetare ose një aktivi financiar tjetër, krijon një pasiv financiar për vlerën aktuale të shumës së shlyerjes (për shembull, për vlerën aktuale të çmimit të riblerjes të ardhshme, të çmimit të ushtrimit të ospionit ose të ndonjë shume tjetër shlyerjeje). Kjo vlen edhe në rast se vetë kontrata është një instrument i kapitalit të vet. Një shembull...

Provizionet për shlyerjet e kushtëzuara

- 25 Një instrument financiar mund të kërkojë që njësi ekonomike të lëvrojë mjete monetare ose një aktiv financiar tjetër ose ndryshe të shlyejë në një mënyrë të tillë që do ishte një pasiv financiar, në rast të ndodhjes ose mosndodhjes të ngjarjeve të pasigurta në të ardhmen (ose kur shfaqen disa rrethana të pasigurta) të cilat janë përtej kontrollit të emetuesit dhe mbajtësit të instrumentit, të tilla si një ndryshim në indeksin e tregut të kapitalit, në indeksin e çmimeve të konsumit, në normën e interesit ose kërkesat tatimore, ose në të ardhurat e ardhshme të emetuesit, në të ardhurat neto apo në raportin borxh/kapital. Emetuesi i një instrumenti të tillë nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shmangur lëvrimin e mjeteve monetare ose të një aktivi financiar tjetër (ose të shlyejë ndryshe në mënyrë të tillë që do të ishte pasiv financiar). Prandaj, ai është pasiv financiar për emetuesin përveç rasteve kur:
- (a) pjesa e provizionit për për shlyerje të kushtëzuar që mund të kërkonte shlyerjen në mjete monetare ose në aktiv financiar tjetër (ose ndryshe në një mënyrë që do të ishte një pasiv financiar) nuk është e vërtetë;
 - (b) emetuesit mund t'i kërkojë të shlyejë detyrimin në mjete monetare ose në aktiv financiar tjetër (ose të shlyejë ndryshe në një mënyrë që do të ishte pasiv financiar) vetëm në rast të likuidimit të emetuesit; ose
 - (c) instrumenti ka të gjitha tiparet dhe plotëson kushtet e dhëna në paragrafët 16A dhe 16B.

Para paragrafit 96 është ndryshuar titulli. Pas paragrafit 96 janë shtuar paragrafët 96A–96C. Pas paragrafit 97B është shtuar paragrafi 97C.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

- 96A *Instrumentat Financiarë të Kthyeshëm dhe Detyrimet që Lindin nga Likuidimi* (Ndryshime në SNK 32 dhe SNK 1), publikuar në Shkurt 2008, kërkon që instrumentat financiarë që gëzojnë të gjitha tiparet dhe plotësojnë kushtet e paragrafëve 16A dhe 16B ose paragrafëve 16C dhe 16D të klasifikohen si instrumenta të kapitalit të vet, paragrafët e ndryshuar 11, 16, 17–19, 22, 23, 25, AG13, AG14 dhe AG27, dhe paragrafët e shtuar 16A–16F, 22A, 96B, 96C, 97C, AG14A–AG14J dhe AG29A. Një njësi ekonomike duhet të zbatohet këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2009 e më pas. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatohet njëkohësisht ndryshimet përkatëse për SNK 1, SNK 39, SNRF 7 dhe KIRFN 2.
- 96B *Instrumentat Financiarë të Kthyeshëm dhe Detyrimet që Lindin nga Likuidimi ka përfshirë* një përjashtim të kufizuar të fushëveprimit, prandaj një njësi ekonomike nuk duhet të zbatohet përjashtimin për analogji.
- 96C Klasifikimi i instrumentave sipas këtij përjashtimi duhet të kufizohet për trajtimin kontabël të instrumentave të tillë sipas SNK 1, SNK 32, SNK 39 dhe SNRF 7. Instrumenti nuk duhet të konsiderohet si instrument i kapitalit të vet sipas udhëzimeve të tjera për shembull SNRF 2 *Pagezat e bazuara në aksione*.
- 97C Ndërsa zbaton ndryshimet e përshkruara në paragrafin 96A, një njësi ekonomike duhet të ndajë një instrument financiar të përbërë me një detyrim për të lëvruar tek pala tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim, në përbërës të veçantë të pasivit dhe të kapitalit të vet. Nëse përbërësi pasiv nuk është më për t'u shlyer, zbatimi retrospektiv i këtyre ndryshimeve në SNK 32 do të përfshijë ndarjen e dy përbërësve të kapitalit të vet. Përbërësi i parë do të jetë në fitimin e pashpërndarë dhe përfaqson interesin e akumuluar rritës të përbërësit pasiv. Përbërësi tjetër do të përfaqësojë përbërësin fillestar të kapitalit të vet. Prandaj një njësi ekonomike nuk duhet të veçojë këto dy përbërës nëse përbërësi pasiv nuk është më për t'u shlyer në datën e zbatimit të ndryshimit.

Në Shtojcën *Udhëzim për Zbatim* janë ndryshuar paragrafët AG13 dhe AG14. Pas paragrafit AG14 janë shtuar një titull, paragrafët AG14A–AG14D, një tjetër titull, paragrafi AG14E, një titull tjetër, paragrafët AG14F–AG14I, një titull tjetër dhe paragrafi AG14J.

Instrumentat e kapitalit të vet

- AG13 Shembuj të instrumentave të kapitalit përfshijnë aksionet e zakonshme jo-të kthyeshme, disa instrumenta të kthyeshëm (shih paragrafët 16A dhe 16B), disa instrumenta që i krijojnë njësisë ekonomike një detyrim për të lëvruar tek pala tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim (shih paragrafët 16C dhe 16D), disa tipe aksionesh preferenciale (shih paragrafët AG25 dhe AG26) dhe obligacionet e konvertueshme ose opsionet për blerje të nënshkruara që i lejojnë mbajtësit të nënshkruarë ose të blejë një numër të caktuar të aksioneve të zakonshme jo-të kthyeshme në njësinë ekonomike emetuese në këmbim të një shume të caktuar të mjeteve monetare ose të një aktivi financiar tjetër. Detyrimi që ka njësi ekonomike për të emetuar ose blerë një numër të caktuar të instrumentave të vet të kapitalit në këmbim të një shume të caktuar të mjeteve monetare ose të një aktivi financiar tjetër është një instrument i kapitalit të vet të njësisë ekonomike (përveç sa theksohet në paragrafin 22A). Megjithatë, nëse një kontratë e tillë përmban një detyrim për njësinë ekonomike që të paguajë në mjete monetare ose në një aktiv financiar tjetër (të ndryshëm nga një kontratë e klasifikuar si kapital i vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose me paragrafët 16C dhe 16D), ajo krijon edhe një pasiv për vlerën aktuale të shumës së shlyerjes (shih paragrafin AG27(a)). Një emetues i aksioneve të zakonshme jo-të kthyeshme merr përsipër një detyrim kur vepron në mënyrë formale për të shpërndarë dhe bëhet ligjërish i detyruar ndaj aksionmbajtësve për të vepruar në këtë mënyrë. Ky mund të jetë rasti i deklarimit të dividendëve ose kur njësi ekonomike mbyll aktivitetin dhe aktivet e mbetura pas shlyerjes së detyrimeve janë të disponueshme për t'u shpërndarë aksionmbajtësve.
- AG14 Një opsion për blerje i blerë ose një kontratë tjetër e ngjashme e siguruar nga një njësi ekonomike që i jep të drejtën të riblejë një numër të caktuar të instrumentave të vet të kapitalit në këmbim të lëvrimin të një shume të caktuar të mjeteve monetare ose të aktivi financiar tjetër, nuk është aktiv financiar i njësisë ekonomike (përveç sa theksohet në paragrafin 22A). Ndërsa çdo shumë e paguar për një kontratë të tillë zbritet nga kapitali i vet.

Klasa e instrumentave që është në varësi të gjithë klasave të tjera (paragrafët 16A(b) dhe 16C(b))

- AG14A Një nga tiparet e paragrafëve 16A dhe 16C është se instrumenti financiar është në klasën e instrumentave që është në varësi të gjithë klasave të tjera.
- AG14B Kur përcaktohet nëse një instrument bën pjesë në një klasë të varur, njësi ekonomike vlerëson kërkesat ndaj instrumentit në likuidim njëllë sikur likuidimi të ndodhë në datën kur klasifikohet instrumenti. Një njësi

ekonomike duhet të rivlerësojë klasifikimin kur ka ndryshime në rrethanat e rëndësishme. Për shembull, nëse njësisia ekonomike emeton ose shlyen një instrument financiar tjetër, kjo mund të ndikojë nëse instrumenti në fjalë është ose jo në klasën e instrumentave që është në varësi të të gjitha klasave të tjera.

- AG14C Një instrument që ka një të drejtë preferenciale në likuidimin e njësisë ekonomike nuk është një instrument që jep të drejtën e një pjese proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike. Për shembull, një instrument ka një të drejtë preferenciale në likuidim nëse i jep mbajtësit të drejtën për një dividend të caktuar në likuidim, përveç një pjese në aktivet neto të njësisë ekonomike, kur instrumenta të tjerë në klasën e varur që kanë të drejtën e një pjese proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike nuk kanë të njëjtën të drejtë në likuidim.
- AG14D Nëse një njësi ekonomike ka vetëm një klasë të instrumentave financiarë, kjo klasë duhet të trajtohet si të ishte e varur ndaj të gjitha klasave të tjera.

Flukset gjithsej të pritshme të mjeteve monetare që i përkasin instrumentit përgjatë jetës së instrumentit (paragrafi 16A(e))

- AG14E Flukset gjithsej të pritshme të mjeteve monetare që i përkasin instrumentit përgjatë jetës së instrumentit duhet të bazohen kryesisht në fitimin ose humbjen, ndryshimin në aktivet neto të njohura ose në vlerën e drejtë të aktiveve neto të njohura dhe të panjohura të njësisë ekonomike përgjatë jetës së instrumentit. Fitimi ose humbja dhe ndryshimi në aktivet neto të njohura do të matet në përputhje me SNRF-të përkatëse.

Transaksionet në të cilat merr pjesë një mbajtës instrumenti, që nuk është pronar i njësisë ekonomike (paragrafët 16A dhe 16C)

- AG14F Mbajtësi i një instrumenti financiar të kthyeshëm ose një instrumenti që i krijon njësisë ekonomike një detyrim për të lëvruar tek pala tjetër një pjesë proporcionale të të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim, mund të hyjë në transaksione me njësiën ekonomike në një rol të ndryshëm nga ai pronarit. Për shembull një mbajtës i instrumentit mund të jetë edhe punonjës i njësisë ekonomike. Vetëm flukset monetare dhe kushtet kontraktuale të instrumentit që lidhet me mbajtësin e instrumentit si pronar i njësisë ekonomike duhet të merren në konsideratë kur vlerësohet nëse instrumenti duhet të klasifikohet si capital i vet sipas paragrafit 16A ose paragrafit 16C.
- AG14G Një shembull është një bashkëpronësi me përgjegjësi të kufizuar në të cilën ka ortakë të përgjithshëm dhe të kufizuar. Disa nga ortakët me të drejta të plota mund të japin një garanci për njësinë ekonomike dhe të shpërblehen për dhënien e garancisë. Në rrethana të tilla, garancia dhe flukset monetare lidhen me mbajtësit e instrumentit në rolin e tyre si garantues dhe jo në rolin e tyre si pronarë të njësisë ekonomike. Prandaj një garanci e tillë fluset monetare përkatëse nuk do të bëjnë që ortakët me të drejta të plota të konsiderohen si të varur ndaj ortakëve me të drejta të kufizuara dhe nuk do të merren parasysh kur vlerësohet nëse kushtet kontraktuale të instrumentave të bashkëpronësisë me përgjegjësi të kufizuar dhe bashkëpronësisë me përgjegjësi të pakufizura janë identike.
- AG14H Një tjetër shembull është marrëveshja e ndarjes së fitimit ose humbjes e cila shpërndan fitimin ose humbjen tek mbajtësit e instrumentit në bazë të shërbimeve të dhëna ose aktivitetit të kryer gjatë vitit aktual dhe viteve të mëparëshëm. Marrëveshje të tilla janë transaksione me mbajtësa instrumentash në rolin e tyre si jo-pronarë dhe nuk duhet të merren në konsideratë kur vlerësohen tiparet e radhitura në paragrafin 16A ose paragrafin 16C. Megjithatë, marrëveshjet për ndarjen e fitimit ose humbjes që shpërndajnë fitimin ose humbjen tek mbajtësit e instrumentit bazohen në shumën nominale të instrumentave të tyre të krahasuara me të tjerat në klasë, përfaqsojnë transaksione me mbajtës instrumentash në rolin e tyre si pronarë dhe duhet të merren në konsideratë kur vlerësohen tiparet e radhitura në paragrafin 16A ose paragrafin 16C.
- AG14I Flukset e mjeteve monetare dhe kushtet kontraktuale të një transaksioni mes mbajtësit të instrumentit (në rolin si jo-pronar) dhe njësisë ekonomike emetuese duhet të jenë të ngjashme me një transaksion të barasvlefshëm që mund të ndodhë mes një jo-mbajtësi instrumenti dhe njësisë ekonomike emetuese.

Asnjë instrument tjetër financiar ose kontratë me flukes gjithsej të mjeteve monetare që fikson ose kufizon kryesisht kthimin e mbetur tek mbajtësi i instrumentit (paragrafët 16B dhe 16D)

- AG14J Për të klasifikuar një instrument financiar si kapitali i vet, që plotëson kriteret në paragrafin 16A ose paragrafin 16C, një kusht është që njësisia ekonomike të mos ketë instrumenta të tjerë financiarë ose kontrata që kanë (a) flukse monetar totale që bazohen kryesisht në fitimin ose humbjen, në ndryshimin në aktivet neto të njohura ose ndryshimin në vlerën e drejtë të aktiveve neto të njohura dhe të panjohura të njësisë ekonomike dhe (b) efekt kryesisht kufizues ose të fuksuar të kthimit të mbetur. Instrumentat në vijim, kur krijohen në kushte tregtare

normale me palë të palidhura ka pak mundësi që të pengojnë nga klasifikimi si kapitali i vet, instrumentat që ndryshe do të plotësonin kërkesat e paragrafit 16A ose paragrafit 16C:

- (a) instrumentat me flukse totale të mjeteve monetare kryesisht të bazuar në aktivet specifike të njësisë ekonomike.
- (b) instrumentat me flukse totale të mjeteve monetare të bazuara në një përqindje mbi të ardhurat.
- (c) kontratat e ndërtuara për të shpërblyer punonjësit individualë për shërbimet që i kanë dhënë njësisë ekonomike.
- (d) kontratat që kërkojnë pagesën e një përqindjeje të parëndësishme të fitimit për shërbime të dhëna ose mallrat e furnizuara.

Paragrafi AG27 është ndryshuar dhe pas paragrafit AG29 është shtuar paragrafi AG29A.

AG27 Shembujt në vijim ilustrojnë mënyrën si klasifikohen tipe të ndryshme të kontratave në instrumenta të kapitalit të vet të një njësie ekonomike:

- (a) Një kontratë që do të shlyhet nga njësia ekonomike duke marrë ose lëvruar një numër të caktuar të aksioneve të saj jo për shumën të ardhshme, ose në këmbim të një numri të caktuar të aksioneve të veta për një shumë të caktuar në mjete monetare ose në një aktiv financiar tjetër, është një instrument i kapitalit të vet (përveç sa theksohet në paragrafin 22A). Prandaj çdo shumë e marrë ose e paguar për një kontratë të tillë i shtohet ose i zbritet drejtpërdrejt kapitalit të vet. Një shembull është një aksion me opsion aksioni i emetuar, i cili i jep palës tjetër të drejtën të blejë një numër të caktuar të aksioneve të njësisë ekonomike për një shumë të caktuar të mjeteve monetare. Megjithatë, nëse kontrata kërkon që njësia ekonomike të blejë (shlyejë) aksionet e veta me mjete monetare ose me një aktiv financiar tjetër në një datë të caktuar ose kur kërkohet, njësia ekonomike njih edhe një pasiv financiar për vlerën aktuale të shumës së shlyer (me përjashtim të instrumentave që gëzojnë të gjitha tiparet dhe plotësojnë kushtet e dhëna në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D). Një shembull është një detyrim i njësisë ekonomike sipas një kontratë të ardhshme për të riblerë një numër të caktuar të aksioneve të veta për një shumë të caktuar në mjete monetare.
- (b) Detyrimi i një njësie ekonomike për të blerë aksionet e veta kundrejt mjeteve monetare krijon një pasiv financiar për vlerën aktuale të shumës së shlyerjes edhe nëse numri i aksioneve që njësia ekonomike duhet të riblejë nuk është fiks ose nëse detyrimi është i kushtëzuar nga ushtrimi i të drejtës për shlyerje nga pala tjetër (përveç sa theksohet në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D). Një shembull i detyrimit të kushtëzuar është një opsion i emetuar që kërkon që njësia ekonomike të riblejë aksionet e veta kundrejt mjeteve monetare nëse pala tjetër e ushtron opsionin.
- (c) Një kontratë që do të shlyhet në mjete monetare ose në një aktiv financiar tjetër është aktiv financiar ose pasiv financiar madje edhe nëse shumën e mjeteve monetare ose e aktivitetit financiar tjetër që do të merret ose do të lëvrohet bazohet në ndryshimet në çmimin e tregut të kapitalit të vet të njësisë ekonomike (përveç sa theksohet në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D). Një shembull është opsioni për aksione të shlyera në mjete monetare neto.
- (d) ...

AG29A Disa tipe instrumentash që krijojnë një detyrim kontraktual për njësinë ekonomike klasifikohen si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D. Klasifikimi në përputhje me këta paragrafë është një përjashtim nga parimet e tjera të zbatuara në këtë Standard për klasifikimin e një instrumenti. Ky përjashtim nuk shtrihet edhe për klasifikimin e interesave jo-kontrolluese në pasqyrat financiare të konsoliduara. Prandaj, instrumentat e klasifikuara si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D në pasqyrat financiare të veçanta ose individuale të cilat janë interesa jo-kontrolluese, në pasqyrat financiare të grupit, klasifikohen si pasive.

Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare (rishikuar në 2007)

Përcaktimet

Pas paragrafit 8 është shtuar paragrafi 8A.

8A Termat në vijim janë përshkruar në SNK 32 *Instrumentat Financiarë: Paraqitja* dhe përdoren në këtë Standard me kuptimin e specifikuar në SNK 32:

- (a) instrumenti financiar i kthyeshëm klasifikohet si një instrument i kapitalit të vet (përshkruar në paragrafët 16A dhe 16B të SNK 32)
- (b) një instrument që i krijon njësisë ekonomike një detyrim për të lëvruar tek një palë tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim dhe klasifikohet si një instrument i kapitalit neto (përshkruar në paragrafët 16C dhe 16D të SNK 32).

Informacion që duhet të paraqitet në pasqyrën e gjendjes financiare ose në shënimet shpjeguese

Pas paragrafit 80 është shtuar paragrafi 80A.

80A Nëse një njësi ekonomike ka riklasifikuar

- (a) një instrument financiar të kthyeshëm të klasifikuar si një instrument të kapitalit të vet, ose
- (b) një instrument që i krijon njësisë ekonomike një detyrim për të lëvruar tek një palë tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim dhe është klasifikuar si një instrument i kapitalit të vet

mes pasiveve financiare dhe kapitalit të vet, duhet të japë informacion shpjegues për shumën e riklasifikuar brenda dhe jashtë çdo kategorie (pasiv financiar ose kapital i vet), dhe për kohën e arsytet për këtë riklasifikim.

Pas paragrafit 136 është shtuar një titull dhe paragrafi 136A. Paragrafi 138 është ndryshuar.

Instrumentat financiarë të kthyeshëm të klasifikuar si kapital i vet

136A Për instrumentat financiarë të kthyeshëm të klasifikuara si instrumenta të kapitalit të vet një njësi ekonomike duhet të japë këto informacione shpjeguese (deri në masën që nuk është paraqitur tjetërkund):

- (a) përmbledhje e të dhënave sasiore rreth shumës së klasifikuar si kapital neto;
- (b) objektivat e saj, politikat dhe proceset për manaxhimin e detyrimeve të saj për riblerjen ose shlyerjen e instrumentave kur kjo kërkohet nga mbajtësit e instrumentave, përfshirë çdo ndryshim nga nga periudha e mëparëshme;
- (c) fluksin dalës të pritshëm të mjeteve monetare në shlyerjen ose riblerjen e asaj klase të instrumentave financiarë; dhe
- (d) informacion rreth mënyrës si përcaktohet fluksi dalës i pritshëm i mjeteve monetare në shlyerje ose riblerje.

Dhënia e informacioneve shpjeguese të tjera

138 Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjeguese për sa vijon, nëse nuk është paraqitur tjetërkund në informacionin e publikuar me pasqyrat financiare:

- (a) adresën dhe formën ligjore të njësisë ekonomike, vendin e regjistrimit dhe adresën e zyrës së regjistruar (ose të vendit kryesor të aktivitetit nëse është i ndryshëm nga zyra e regjistruar);
- (b) një përshkrim të natyrës së operacioneve të njësisë ekonomike dhe aktiviteteve kryesore të saj;
- (c) emrin e shoqërisë mëmë dhe shoqërisë mëmë më të fundit të grupit; dhe
- (d) nëse është njësi ekonomike me jetë të kufizuar, informacion rreth jetëgjatësisë së saj.

Pas paragrafit 139A është shtuar paragrafi 139B.

Dispoziat kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

139B *Instrumentat Financiarë të Kthyeshëm dhe detyrimet që Lindin në Likuidim* (Ndryshimet në SNK 32 dhe SNK 1), publikuar në Shkurt 2008, ndryshon paragrafin 138 dhe shton paragrafët 8A, 80A dhe 136A. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2009 ose më pas. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse njësia ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo

duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatojë njëkohësisht ndryshimet përkatëse në SNK 32, SNK 39, SNRF 7 dhe KIRFN 2 *Pjesët (aksionet) e Anëtarëve në Njësitë Ekonomike të Përbashkëta dhe Instrumentat e Ngjashëm*.

Ndryshimet në SNRF 7, SNK 39 dhe KIRFN 2

Kur zbatojnë ndryshimet përkatëse në SNK 32 dhe SNK 1, njësitë ekonomike duhet të zbatojnë edhe ndryshimet në vijim në SNRF 7, SNK 39 dhe KIRFN 2.

SNKRF 7 *Instrumentat Financiarë: Paraqitja*

Paragrafi 3 ndryshohet.

Objekti

- 3 Ky SNRF do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha tipet e instrumentave financiarë përveç:
- (a) ...
 - (f) instrumentave që kërkohen të klasifikohen si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D të SNK 32.

Pas paragrafit 44B shtohet paragrafi 44C.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

- 44C Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimin në paragrafin 3 për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2009 e më pas. Nëse një njësi ekonomike zbaton *Instrumentat Financiarë të Kthyeshëm dhe detyrimet që Lindin në Likuidim* (Ndryshime në SNK 32 dhe SNK 1), publikuar në Shkurt 2008, për një periudhë më të hershme, ndryshimi në paragrafin 3 duhet të zbatohet edhe për këtë periudhë më të hershme.

SNK 39 *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja*

Paragrafi 2(d) ndryshohet.

Objekti

- 2 Ky Standard duhet të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjithë instrumentat financiare përveç:
- (d) instrumentave financiarë të emetuar nga njësia ekonomike, të cilat plotësojnë përkufizimin e një instrumenti të kapitalit të vet të dhënë në SNK 32 (përfshirë opsionet dhe garancitë) ose që kërkohen të klasifikohen si një instrument i kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D të SNK 32. Megjithatë, mbajtësi i një instrumenti të tillë të kapitalit të vet do të zbatojë këtë Standard për këto instrumenta, përveç rasteve kur plotësohet kërkesa përjashtimore e dhënë në pikën (a) mësipër.

Pas paragrafit 103E është shtuar paragrafi 103F.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

- 103F Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimin në paragrafin 2 për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2009 ose më pas. Nëse një njësi ekonomike zbaton *Instrumentat Financiarë të Kthyeshëm dhe Detyrimet që Lindin*

në *Likuidim* (Ndryshime në SNK 32 dhe SNK 1), publikuar në Shkurt 2008, për një periudhë më të hershme, ndryshimi në paragrafin 2 duhet të zbatohet edhe për këtë periudhë më të hershme.

KIRFN 2 Pjesët (aksionet) e Anëtarëve në Njësitë Ekonomike të Përbashkëta dhe Instrumentat e Ngjashëm

Në seksionin e Referencave është ndryshuar shënimi në fund të faqes.

* Në Gusht 2005, SNK 32 u ndryshua në SNK 32 *Instrumentat Financiarë: Paraqitja*. Në Shkurt 2008 BSNK ndryshoi SNK 32 duke kërkuar që instrumentat të klasifikohen si të kapitalit të vet nëse këto instrumenta gëzojnë të gjitha tiparet dhe plotësojnë kushtet në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D të SNK 32.

Paragrafët 6 dhe 9 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 14^a.

Konsensus

- 6 Aksionet e anëtarëve që mund të klasifikoheshin si të kapitalit të vet nëse anëtarët nuk kishin të drejtën për të kërkuar shlyerje, janë të kapitalit të vet nëse janë të pranishme kushtet e përshkruara në paragrafët 7 dhe 8 ose aksionet e anëtarëve kanë të gjitha tiparet dhe plotësojnë kushtet në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D të SNK 32. Depozitat e kërkueshme, përfshirë llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kursimit dhe kontrata të ngjashme që krijohen kur anëtarët veprojnë si klientë janë pasive financiare të njësisë ekonomike.
- 9 Një ndalim i pakushtëzuar mund të jetë absolut, në kuptimin që ndalohej çdo lloj shlyerjeje. Një ndalim i pakushtëzuar mund të jetë i pjeshëm, në atë që ai ndalon shlyerjen e aksioneve të anëtarëve po qe se shlyerja do të mund të shkaktonte rënie të numrit të aksioneve të anëtarëve ose rënie të shumës së kapitalit të paguar nga aksionet e anëtarëve poshtë një niveli të caktuar. Aksionet e anëtarëve që tejkalojnë ndalimin ndaj shlyerjes janë pasive përveç rasteve kur njësi ekonomike ka një të drejtë të pakushtëzuar për të refuzuar shlyerjen siç përcaktohet në paragrafin 7 ose kur aksionet e anëtarëve gëzojnë të gjitha tiparet dhe kushtet në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D të SNK 32. Në disa raste numri i aksioneve ose shuma e kapitalit të paguar që është objekt i një ndalimi shlyerjeje mund të ndryshojë herë pas here. Një ndryshim i tillë në ndalimin për shlyerje çon një transferim mes pasivitetit financiar dhe kapitalit të vet.

Data e hyrjes në fuqi

- 14A Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimet në paragrafët 6, 9, A1 dhe A12 për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2009 ose më pas. Nëse një njësi ekonomike zbaton *Instrumentat Financiarë të Kthyesëm dhe Detyrimet që Lindin në Likuidim* (Ndryshime në SNK 32 dhe SNK 1), publikuar në Shkurt 2008, për një periudhë më të hershme, ndryshimet në paragrafët 6, 9, A1 dhe A12 duhet të zbatohen edhe për këtë periudhë më të hershme.

Në Shtojcë (Shembuj të zbatimit të konsensusit) janë shtuar paragrafët A1 dhe A12.

Shembuj të zbatimit të konsensusit

- A1 Kjo shtojcë paraqet shtatë shembuj të zbatimit të konsensusit të KIRFN. Shembujt nuk përbëjnë një listë shteruese, janë të mundur edhe modele fakti të tjerë. Çdo shembull supozon se nuk ka kushte të tjera përveç atyre të paraqitur në faktet e shembullit, të cilat do të mund të kërkonin që instrumenti financiar të klasifikohet si një pasiv financiar dhe që instrumenti financiar nuk ka të gjitha tiparet ose nuk plotëson kushtet në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D të SNK 32.

Shembull 4

Klasifikimi

A12 Në këtë rast 750,000 NJM mund të klasifikohen si kapital i vet dhe 150,000NJM mund të klasifikohen si pasiv financiar. Përveç paragrafëve të cituar tashmë, paragrafi 18(b) i SNK 32 thekson edhe se:

...një instrument financiar që i jep mbajtësit të drejtën të kthejë tek emetuesi kundrejt mjeteve monetare ose një aktivi financiar tjetër (një 'instrument i kthyeshëm') është një pasiv financiar me përjashtim të instrumentave të klasifikuara si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D. Instrumenti financiar është një pasiv financiar edhe nëse shuma e mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare përcaktohet në bazë të një indeksi ose zëri tjetër që ka mundësi që të rritet ose zvogëlohet. Ekzistenca e një mundësie (opsioni) për mbajtësin që të kthejë instrumentin tek emetuesi kundrejt mjeteve monetare ose një aktivi financiar tjetër nënkupton që instrumenti i kthyeshëm plotëson përcaktimin e një pasivi financiar përveç atyre instrumentave të klasifikua si instrumenta të kapitalit në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D.